

Nr. ____ Prot.
Tiranë ____ . ____ .2023

Nr. 538/1 Prot.
Tiranë 08.05 .2023

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Ndërmjet:

Fondacioni “Tradita Popullore”, një organizatë jo-fitimprurëse në formën e fondacionit, e regjistruar me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Nr. 767, datë 25.09.2019, me numër NUIS L21815452F, me seli në Autostrada Tiranë-Durrës, km 0, Casaitalia, kati 4, Tiranë, përfaqësuar nga Znj. Edlira Sulaj, Drejtore Ekzekutive me numër dokument identifikimi H15404092O si “Tradita Popullore”.

Dhe

Universiteti “Barleti” (UniBa) Institucion i Arsimit të Lartë, me adresë në rr. Frang Bardhi, Nr. 118, Tiranë, përfaqësuar nga Rektori Prof. Dr. Suzana Guxholli.

Neni 1

Qëllimi dhe Objekti

1. Kjo marrëveshje ka si qëllim rregullimin e bashkëpunimit mes institucioneve firmëtare, duke përcaktuar detyrimet e secilës palë.
2. Objekti i kësaj marrëveshje është bashkëpunimi dhe angazhime reciproke në aplikimin e zbatimin të projektit “FIND YOUR OWN ROOTS” dhe nismave në sektorët e mëposhtëm:
 - a. Pjesëmarrje në leksione të stafit drejtues të Fondacionit “Tradita Popullore”;
 - b. Organizimi dhe mediatizimi i aktiviteteve të perbashkëta me bazë trashëgiminë kulturore;
 - c. Pjesëmarrja në praktikatat mesimore dhe trajnuese të studenteve të UMB në implementimin e projektit “FIND YOUR OWN ROOTS”.

Neni 2

Kohëzgjatja e marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në momentin e firmosjes nga përfaqësuesit e të dyja palëve në datën 26/04/2023 dhe mbetet në fuqi për gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit nga data e firmosjes.

Neni 3

Informacion mbi palët

Fondacioni “Tradita Popullore” është krijuar me vendim nr. 391 datë 28.05.2012 të Gjykatës së rrethit Gjyqësor Tiranë, në bazë të ligjit 7850 datë 29.07.1994. Me fitimin e personalitetit juridik, sipas statusit të tij, qëllimi i tij kryesor është kontribimi në krijimin, ruajtjen, dhe ekspozimin e veshjeve dhe materialeve të ndryshme etnografike brenda dhe jashtë vendit, riprodhimin e veshjeve tradicionale duke ruajtur të gjitha praktikatat artizanale të punimit të tyre, përfshirja e materialeve etnografike në

veprimtaritë folklorike të të gjitha niveleve dhe grupmoshave të ndryshme, ruajtja dhe shtimi e njohurive në lidhje me gjuhën, zakonet, traditat dhe në tërësi të trashëgimisë kulturore.

Programeve të trajnimit për të gjitha grupmoshat për mësimin e riprodhimit të veshjeve tradicionale, bizhuve dhe aksesoreve të tjerë që ruajnë trashëgiminë kulturore të vendit tonë;
Aktiviteteve të ndryshme sociale, kulturore dhe arsimore për shpalosjen e vlerave etnografike në të gjitha grupmoshat duke bashkëpunuar me organizata të tjera të kësaj fushe;

- Trajnimeve në aspektin shkencor për stafin që ka krijuar për të ushtruar veprimtarinë e saj;
- Organizimit të ekspozitave, konferencave dhe forumeve mediatike të cilat janë me interes për kulturën, traditën popullore shqiptare në rritjen e njohurive në brezat e ardhshëm;
- Organizimit të vizitave të ndryshme në vendet e rajonit për promovimin e traditës popullore shqiptare. Fondacioni "Tradita Popullore" ka qenë pjesë e aktiviteteve të ndryshme të zhvilluara brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë të cilat kanë pasur si qëllim promovimin e traditave dhe trashëgimisë kulturore të vendit tonë nëpër botë. Këto aktivitete kanë tërhequr vëmendjen e shumë vizitorëve të huaj. Gjithashtu, Fondacioni "Tradita Popullore" ka zhvilluar dhe vazhdon të zhvillojë trajnime të ndryshme në fushën e riprodhimit të kostumeve popullore për të gjithë grupmoshat.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e partnerëve

1. Fondacioni "Tradita popullore":

- a. Fondacioni angazhohet të jetë partner i qëndrueshëm i palëve në marrëveshje në aplikimet e ndryshme në kuadër të programeve të UNOPS EU4CULTURE si dhe donatorëve të tjerë kombëtarë apo ndërkombëtarë;
- b. Fondacioni do të kërkojë ekspertizë në fushën që institucioni partner mbulon, në përputhje me kërkesat dhe kriteret për një ekspertizë të caktuar sic është prezantimi i elementëve të trashëgimisë kulturore nga të rinjtë dhe promovimi i tyre;
- c. Fondacioni do të punojë së bashku me partnerët përmes nismave të përbashkëta, duke ngritur grupe pune;
- d. Fondacioni shpreh vullnetin për të bashkëpunuar e sjellë rezultate pozitive në drejtim të partneritetit dhe realizimit të objektivave.
- e. Personi i kontaktit do të jetë: z./znj. Edlira Sulaj me adresë e-mail: fondacionitraditapopullore@yahoo.com.

2. Universiteti BARLETI (në vijim UniBa):

- a. UniBa angazhohet në bashkëpunim me partnerët, për të ndërmarrë të gjitha nismat dhe hapat e nevojshëm organizativë për programimin e çdo aktiviteti e nisme të rënë dakord midis palëve në zbatim të objektit të kësaj marrëveshje.
- b. UniBa angazhohet në bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen në projekte, trajnime, ëorkshope, forume, konferenca, konsultime, fushata informimi, promovimi e ndërgjegjësimi etj;
- c. UniBa angazhohet të mbështesë dhe t'i ofrojë kontribut palëve në marrëveshje, duke vënë në dispozicion stafin e saj akademik në përputhje me ekspertizën e kërkuar nga projekti/ iniciativa.

3. Palët bashkarisht bien dakort si vijon:

- a. Të punojnë së bashku në drejtim të hartimit të projekt propozimeve në përputhje me thirrjet e donatorëve/ sektorët dhe fushat e përbashkëta të interesit;
- b. Të jenë në kontakt për çdo thirrje të mundshme dhe mundësi bashkëpunimi në partneritet;

- c. Të zbatojnë programet dhe projektet e përbashkëta me interes publik si dhe shkëmbimin e informacionit e dokumentacionit, i cili do të përdoret vetëm për qëllime të realizimit të projekteve;
- d. Të bashkëpunojnë në çdo fushë tjetër të pa listuar më sipër, brenda objektit të tyre dhe për të cilët palët kanë kapacitetet e përshtatshme profesionale.

Neni 5
Dispozita të fundit

1. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet në bazë të konsensusit ndërmjet palëve firmëtare, të shprehur në një dokument të shkruar.
2. Mosrespektimi i detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje bashkëpunimi, nga njëri prej partnerëve, çon detyrimisht në prishjen e saj. Vullneti për mbarimin e marrëveshjes para afatit, komunikohet me shkrim nga partneri, duke argumentuar arsyet e këtij veprimi.
3. Kjo marrëveshje përmban 3 (tre) faqe dhe hartohet në gjuhën shqipe në 3 (tre) kopje origjinale me të njejtën vlerë.

Duke marrë parasysh përcaktimet e mësipërme palët ranë dakord:

Fondacioni Tradita Popullore
Drejtor ekzekutiv
Edlira Sulaj

Edlira Sulaj



Universiteti Barleti
Rektor
Prof. Dr. Suzana Guxholli


